



KOMUNA E MALISHEVËS

BULETINI



Nr. 113- Nëntor 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga zbulimi i bustit të dëshmorit “Hamdi Berisha”
dhe homazheve në varrezat e dëshmorëve, në kuadër të
shënimeve të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë



Përmbajtja:

Malisheva bëhet Qendër të Ngritjes Profesionale.....	2
USAID-i vazhdon të përkrah komunën në realizimin e të hyrave vetanake	3
Ripyllëzohen njëzet hektarë me fidane pishë	4
U përurua libri “Malisheva m’i çeli dyert”	5
KPF-ja dërgoi për Asamble propozimin për emërtimet e rrugëve	5
Shtatë të riatdhesuar gjatë këtij muaji	6
Bashkëpunimi i shkëlqyer mes Komunës dhe OSBE-së	6
U hap ekspozita “Rruga e Lirisë” dhe panairi i librit “Dekada e Librit të Lirisë”	7
Komuna e Malishevës dhe GIZ-i do të rinovojnë Qendrën Rinore	8
Kryetari Kilaj priti komandanti i batalionit turk të KFOR-it, kolonel Eker	9
Në 100 vjetorin e Pavarësisë u nderuan të gjithë dëshmorët e kombit në Malishevë	9
Qeveria Komunale reagon ndaj arrestimeve në rastin “Kleçka”	12
U zbulua busti i dëshmorit “Hamdi Berisha”	12
Reagimi i Kryetarit të Malishevës, z.Isni Kilaj, lidhur me rastin “Kleçka”	13

Malisheva bëhet Qendër të Ngritjes Profesionale

Malishevë, 1 nëntor



Sot në ambientet e SH.M.U. “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, është hapur solemnisht Qendra për Ngritje Profesionale (QNP). Hapja e kësaj qendre është mundësuar nga USAID-Programi BEP, ndërsa prerjen e shirit të kësaj qendre, e bënë Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj dhe udhëheqësi i BEP programit në kuadër të USAID-it, z.Keith Prenton.

“Pjesë e sukseseve tona në zhvillimin e përgjithshëm, janë edhe SHBA-të dhe kjo po dëshmohet edhe me hapjen e kësaj qendre, ndërsa investimi në arsim, është investimi më me ndikim në zhvillimin e një shoqërie. Andaj, e falënderoj përzemërsisht USAID-in, për investimet në këtë fushë, por edhe në fusha të tjera dhe ne ju jemi mirënjohës”, tha mes tjerash, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, me rastin e hapjes së QNP-së.

“Dëshiroj të uroj Kryetarin Kilaj, për investimet e bëra në arsim dhe falënderoj qeverinë komunale, për bashkëpunimin e mrekullueshëm që kanë me USAID-in. Kjo qendër do të kontribuoj për të përmirësuar arsimin në shumë mënyra. Jam i kënaqur edhe me faktin që komuna është duke hartuar planin operativ trevjeçar për zhvillim profesional të mësimeve”, tha z.Keith Prenton, udhëheqës i programit të arsimit (BEP) në USAID-i.

Me këtë rast është hapur “Klasa e shekullit 21”, e cila do të përdoret për mësimin e lëndëve shkencore dhe të teknologjisë, ndërsa QNP në përgjithësi, ka tri komponente të programit të saj: Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të shkollave, Përmirësimin e vlerësimit të rezultateve të nxënies dhe Përmirësimin e Ngritjes Profesionale të mësimeve, pa shprehur nga puna.

USAID-i vazhdon të përkrah komunën në realizimin e të hyrave vetanake



Malishevë, 7 nëntor

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot drejtoreshën e DEMI programit të USAID-it, znj. Ginka Kapitanova, me të cilën kanë biseduar për “fushatën për Të Hyrat Vetanake”, përderisa kanë vlerësuar se në këtë drejtim Malisheva, ka trend

pozitiv, pasi janë shënuar rritje të dukshme në realizimin e të hyrave vetanake, si dhe në regjistrimin (futja në sistem) e të dhënave nga regjistrimi i pronave.

Fillimisht kryetari Kilaj, e ka falënderuar drejtoreshën Kapitanova, “për të gjitha projektet e realizuara së bashku, në kuadër të programit DEMI (Iniciativa për Komuna Demokratike), si dhe në projektet tjera nga USAID-i”.

“Angazhimi juaj ka efekt pozitiv për ne, në realizimin e të hyrave vetanake, por edhe për rritjen e kapaciteteve për personelin që punon në këtë drejtim”, tha mes tjerash Kilaj.

“Jemi të kënaqur me të arriturat së bashku dhe shpresoj që shumë shpejt do të realizohet edhe një projekt për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa për realizimin e të hyrave vetanake, sidomos nga tatimi në pronë, ju duhet të jeni krenar dhe njëherit shembull për komunat tjera. Vazhdoni punën me këto rezultate të mira, në përmirësimin e inkasimit të të hyrave vetanake”, tha drejtoresha e USAID-DEMI programit.

Kilaj dhe Kapitanova, kanë biseduar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fushatën e përkrahur nga USAID-DEMI për të hyrat vetanake, për problemet që ekzistojnë në këtë drejtim, ndërsa është vlerësuar lartë edhe regjistrimi i pronave dhe futja e tyre në sistem.

Më pas znj.Kapitanova, e shoqëruar nga kryetari Kilaj, ka parë nga afër edhe investimet tjera të DEMI programit, në Komunën e Malishevës, si ambientet e punës së shërbimit të gjendjes civile, pastaj sallën e Kuvendit të Komunës, të dy projekte të realizuara nga Komuna e Malishevës dhe USAID-DEMI programi.

Ripyllëzohen njëzet hektarë me fidane pishe

Malishevë, 12 nëntor

Ka filluar ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura, i rreth njëzet hektarëve me fidane të pishës, në territorin e Komunës së Malishevës, falë një projekti të Agjencionit Pyjor të Kosovës (APK), ndërsa sipërfaqja e cila është duke u ripyllëzuar, është gjendet në afërsi të “Shpellës së Flladit” në Panorc.

“Falë një projekti të Agjencionit Pyjor të Kosovës, ka filluar ripyllëzimi i rreth njëzet hektarëve të zhveshura të pyjeve, në rajonin ekonomik afër shpellës në Panorc”, tha drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, në Komunën e Malishevës, z.Sinan Kryeziu.

“Projekti financohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, ndërsa sipërfaqja për ripyllëzim është caktuar nga drejtoria”, bëri të ditur drejtori Kryeziu. Sipas tij, sektori komunal i pylltarisë, është duke e mbikëqyrur projektin e mbjelljes së fidanëve.

Fidanet, të cilat po mbillen në këtë pjesë, janë kryesisht pishë e bardhë dhe pishë e zezë.

U përurua libri “Malisheva m’i çeli dyert”

Malishevë, 13 nëntor

Në kuadër të shënimeve komunale për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, sot në Malishevë, është përuruar libri me poezi “Malisheva m’i çeli dyert”, me autor prof.Hysni Gashi. Ky libër me poezi, i kushtohet kryesisht Malishevës.



“Jam i nderuar që sot po përurohet ky libër, i ish mësuesit patriot Hysni Gashi, i cili ka dhënë kontribut të madh, jo vetëm në arsimin e kësaj ane, por edhe në kultivimin e patriotizmit. Ky libër po shënohet në kuadër të shënimeve për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ky aktivitet, është njëri prej aktiviteteve më të rëndësishme kulturore. Urime të gjithëve 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë”, tha mes tjerash, në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj.

Më pas, për librin dhe për autorin folën, bashkëpunëtor, redaktor dhe recensentë, përderisa, edhe u lexuan disa poezi nga libri “Malisheva m’i çeli dyert”, i autorit Hysni Gashi.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajti mbledhjen e njëmbëdhjetë

KPF-ja dërgoi për Asamble propozimin për emërtimet e rrugëve

Malishevë, 16 nëntor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Asamblesë Komunale të Malishevës, i kryesuar nga kryesuesi Ragip Begaj, sot ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës, në të cilën ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, propozimin e Kryetarit të Komunës për emërtimin e rrugëve.

Anëtarët e KPF-së, me shumicë të votave, e kanë aprovuar dhe e kanë rekomanduar për shqyrtim në Asamble, propozimin e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Malishevës.


Sipas propozimit të Kryetarit, përparësi në emërtimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave, kanë dëshmorët e Komunës së Malishevës, të cilët kanë rënë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Shtatë të riatdhesuar gjatë këtij muaji

Malishevë, 19 nëntor

Në mbledhjen e rregullt të Komitetit për Komunitete, u bë e ditur se, gjatë këtij muaji janë riatdhesuar shtatë persona, gjashtë prej tyre janë kthyer vullnetarisht, ndërsa numri në total i personave të riatdhesuar në Komunën e Malishevës, është 54 persona.

Kështu bëri të ditur sot, zyrtarja për komunitete dhe kthim, znj.Vjolla Krasniqi, sipas të cilës, nga numri total i atyre personave, të cilët kanë aplikuar për mbështetje dhe që i kanë plotësuar kriteret, “ katër persona janë përfitues të orendive shtëpiake, ndërsa tre të tjera janë përfitues për rindërtimin e shtëpive”.



Po ashtu znj.Krasniqi, e njoftoi Komitetin për Komunitete, se në Malishevë, jetojnë 37 persona të komunitetit rom, pastaj 6 persona të komunitetit ashkali, 14 persona janë të padeklaruar dhe një familje amerikane.

Bashkëpunimi i shkëlqyer mes Komunës dhe OSBE-së

Malishevë, 20 nëntor



Bashkëpunimi mes Komunës së Malishevës dhe OSBE-së, është vlerësuar lartë nga i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj dhe ushtruesja e detyrës së Drejtorit Regjional të OSBE-së në Prizren znj.Sara Bonnoti, gjatë një takimi të mbajtur në zyrën e Kryetarit të Komunës në Malishevë.

“Kemi raporte shumë të mira dhe një bashkëpunim të shkëlqyer me zyrtarin e OSBE-së në Malishevë, si dhe jemi të kënaqur me nismat e OSBE-së në

Malishevë”, i ka thënë Kryetari Kilaj, znj.Bonnoti.

“Edhe OSBE është e kënaqur me bashkëpunim tuaj me ekipin e OSBE-së në Malishevë dhe me përkrahjen për realizimin e nismave të ndryshme, që keni realizuar së bashku në komunën tuaj”, tha znj.Bonnoti, duke shfaqur vlerësimet e OSBE-së për bashkëpunimin me komunën.

Gjatë takimit u bisedua edhe për çështje tjera me interes të përbashkët, përfshi edhe draft rregulloren për përdorimin gjuhëve në Komunën e Malishevës, draft i cili tashmë ka kaluar në debat publik, ku debati parë pritet të mbahet në fillim të muajit dhjetor.

U hap ekspozita “Rruga e Lirisë” dhe panairi i librit “Dekada e Librit të Lirisë”

Malishevë, 21 nëntor

Në kuadër të shënimeve të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, është hapur ekspozita me fotografi “Rruga e Lirisë” dhe panairi i librit “Dekada e Librit të Lirisë”, të organizuara nga Radio Kosovaelirë dhe redaksia e librit “Dëshmorët e UÇK-ës”.

“Kjo ekspozitë është pjesë e aktiviteteve kulturore në kuadër të shënimeve të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe përmes kësaj ekspozite, sillen kujtimet dhe



faktet e luftës dhe heroizmave të dëshmorëve tanë”, tha Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, me rastin e hapjes së kësaj ekspozite. “Mos e harroni të kaluarën, për të ndërtuar identitetin tonë”, tha në fund kryetari Kilaj, duke i porositur brezat e rinj.

Ndërsa në fund të hapjes, Ahmet Qeriqi, nga radio “Kosovaelirë”, tha se “këto fotografi janë bërë nga fotoreporterët e radios “Kosovaelirë” dhe Agjencisë së Lajmeve “KosovaPress”, gjatë kohës së luftës.

Ekspozita do të jetë e hapur nga sot, deri më 23 nëntor në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.

Komuna e Malishevës dhe GIZ-i do të rinovojnë Qendrën Rinore

Malishevë, 21 nëntor

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj dhe udhëheqësi i GIZ-EDYK në Kosovë, z.Guenter Grzybek, kanë nënshkruar sot marrëveshjen e bashkëpunimit për renovimin dhe pajisjen e Qendrës Rinore në Malishevë.

“Unë ju falënderoj për gatishmërinë tuaj për të mbështetur Qendrën e Rinisë dhe rininë e Malishevës në përgjithësi, përmes këtij investimi” tha kryetari Kilaj, duke e falënderuar përfaqësuesin e Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).



Po ashtu edhe përfaqësuesi i GIZ-it, z.Guenter Grzybek, i cili udhëheq programin për Fuqizimin dhe Zhvillimin e Rinisë (EDYK), u shpreh i “kënaqur me bashkëpunimin me Komunën dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport”.

Sipas kësaj marrëveshje, GIZ-EDYK, do të mbështet në renovim dhe pajisje Qendrën Rinore të Malishevës, në vlerë prej tetë mijë eurove, ndërsa komuna, do të merr përsipër pjesën tjetër të rregullimit të Qendrës Rinore, kurse i tërë projekti pritet për përfundoj në qershor të vitit 2013.

Kryetari Kilaj priti komandanti i batalionit turk të KFOR-it, kolonel Eker

Malishevë, 22 nëntor



Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot komandantin e batalionit turk të KFOR-it, kolonelin Eker, me bashkëpunëtor, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin me KFOR-in, zhvillimin e përgjithshëm të Malishevës, si dhe çështjet e sigurisë.

Kryetari Kilaj, e njoftoi eprorin turk të KFOR-it, për zhvillimet e përgjithshme në Malishevë, si dhe e falënderoi atë, për kontributin që Turqia, ka dhënë në kuadër të NATO-

s, për çlirimin e vendit, si dhe për përkrahjen në zhvillimin e përgjithshëm të pasluftës në Kosovë.

Ndërsa, koloneli Eker, tha se “Kosova ka një të ardhme të mirë, duke u bazuar në zhvillimet e deritanishme, pasi deri më tani është zhvilluar mjaft duke marrë parasysh faktorët e shumtë, që kanë bërë që Kosova të ketë vështirësi të shumta”.

Eker e Kilaj, u pajtuan se në Malishevë, siguria është në nivel të mirë dhe se në Malishevë, investitorët e mundshëm, janë të sigurt të investojnë. Për këtë çështje, kryetari Kilaj, e informoi kolonelin turk, edhe për lehtësirat që Komuna e Malishevës, ofron për investitorët.

U mbajt mbledhje solemne për 28 Nëntor

Në 100 vjetorin e Pavarësisë u nderuan të gjithë dëshmorët e kombit në Malishevë

Malishevë, 23 nëntor



Në kuadër të shënimeve për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, ftuar nga Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, u mbajt në mbledhje solemne, në të cilën morën pjesë familjet e dëshmorëve nga Malisheva, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Halit Krasniqi, pastaj veteran të luftës së UÇK-së, këshilltarët komunal dhe qytetar të shumtë.

Për rëndësinë e 28 Nëntorit, në emër të të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës, foli Kryetari Isni Kilaj, ndërsa në emër të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, foli veterani z.Enver J. Hoti.

Për kontributin e dhënë, në luftën e fundit, si pjesë e rrugëtimit të popullit shqiptar, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, i ka nderuar me mirënjohje, familjet e 75 dëshmorëve të kombit, nga Komuna e Malishevës.

Paraprakisht, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë.

Pas mbledhjes solemne, u dha edhe një program i pasur kulturor dhe artistik, me artist të njohur të estradës shqiptare.

Në vazhdim, fjalimi i kryetarit Isni Kilaj, mbajtur në mbledhjen solemne:

Komuna e Malishevës

Kryetari i Komunës

Malishevë 23 nëntor 2012

Të nderuar këshilltarë komunal,

Të nderuara familje të dëshmorëve, invalid dhe veteran të luftës,

Të nderuar miq,mysafirë dhe qytetarë të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Kam nderin e veçantë t'ju drejtohem me këtë fjalë rasti në shënimin e Njëqindvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, akt ky i cili përbënë arritjen më të madhe të këtij shekulli për shqiptarët kudo që janë përderisa ne përjetësisht do të bëjmë nderimin më të madh të gjithë atyre burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, që flijuan jetën e tyre për këtë ditë të madhe.

Ne edhe sot përulemi para veprimit kur plaku i urtë dhe mendjendritur, gjeniu dhe vizionari Ismail Qemajli në Vlorë me 28 nëntor 1912 i ndihmuar nga burra të mëdhenj të kombit SHPALLI Pavarësinë e Shqipërisë në kohën kur në tryezat diplomatike dhe hartat ushtarake të kohës po përgatitej fshirja e shqiptarëve nga harta e botës.

Ky veprim,shpëtoj një pjesë të trungut shqiptar e cila më pastaj u bë mbështetje për liri dhe bashkim kombëtarë që ishte dhe mbetet ideal dhe gjakim i shqiptarëve që vazhdojnë të jetojnë në trojet e ndara padrejtësisht.

Të nderuar pjesëmarrës, zonja dhe zotërinj;

Një shekull Pavarësi për ne në Kosovë që jetonim nën zgjedhën serbe ishte pothuaj një shekull i përpjekjeve për liri dhe bashkim kurse data 28 nëntor ka qenë datë fati pasi me 28 nëntor 1955 në Prekaz lindi komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari kurse me 28 Nëntor 1997 në Llaushë të Skënderajt doli publikisht në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës e cila me luftën e saj heroike i dha fund sundimit gjakatar serb në Kosovë.

Me shpalljen e Aktit të Pavarësisë së Kosovës nga kryeministri Hashim Thaqi me 17 shkurt 2008 ndërkaq realizohet amaneti i mbi 3000 dëshmorëve dhe mijëra e mijëra martirëve të Kosovës përderisa gjithmonë, deri në realizim synim mbetet Bashkimi Kombëtar që është moto e punës së shqiptarëve kudo që janë.

Të nderuar bashkëqytetar;

Në tërë këtë histori të lavdishme, Malisheva gjithsesi ka hisen e saj pasi qytetarët e saj në të gjitha zhvillimet dhanë kontributin e madh duke mos kursyer as jetën as mundin dhe as pasurinë e tyre.

Kujtojmë me këtë rast luftën e fundit të UÇK-së në të cilën ranë 75 dëshmorë të komunës sonë kurse të gjitha vendbanimet e saj u bënë arenë lufte dhe qëndrese për liri.

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj:

Në decenien e fundit, me krejt mundësit tona, kemi realizuar qindra projekte të cilat kanë përmirësuar dukshëm jetën e banorëve të komunë së Malishevës.

Në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë ne po realizojmë projektin më të madh kombëtarë, atë të RRUGËS SË KOMBIT e cila do të përurohet vetëm pas 4 ditësh dhe e cila edhe fizikisht lidh Shqipërinë me Kosovën që ishte ideal i brezave që nga ndarja e saj e pa drejtë.

Ne në Malishevë, kemi arsye shtesë për kremte pasi Rruga e Kombit kalon përmes vendbanimeve tona duke u hap perspektivë për një jetë më të mirë qytetarëve tanë.

Edhe në këtë përvjetor, zotohem para qytetarëve të Malishevës se do të përdorim krejt kapacitetet materiale dhe intelektuale për të përmirësuar jetën tuaj kurse asnjëherë nuk do të heqim dorë nga ideali i madh i BASHKIMIT KOMBËTARË.



Të nderuar të pranishëm:

URIME 100 VJETORI I PAVARËSISË,

Rroftë përjetë Shqipëria dhe shqiptarët!

Nga mbledhja Këshillit të Drejtorëve

Qeveria Komunale reagon ndaj arrestimeve në rastin “Kleçka”

Malishevë, 26 nëntor

Qeveria Komunale e Malishevës, në mbledhjen e rregullt të së hënës, e udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka reaguar ndaj arrestimeve të ditëve të fundit, të katër personave në rastin “Kleçka”. Me këtë rast, Qeveria Komunale e Malishevës, shpreh mbështetjen për bashkëluftëtarët dhe shpreh edhe njëherë qëndrimin e saj, se lufta e UÇK-së, ka qenë luftë e drejtë.

“Shprehim mbështetjen morale në të gjitha aspektet, për bashkëluftëtarët tanë dhe besojmë se përsëri do të fitoj drejtësia, si edhe herët tjera”, ka thënë mes tjerash Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve.

“Ky akt i arrestimit të bashkëluftëtarëve tanë, ndodhi në vigjilje të festimit të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe ky akt i ndodhur, pikërisht në këtë kohë, është i papranueshëm”, tha kryetari Kilaj, në emër të Qeverisë Komunale të Malishevës.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, u diskutuan edhe çështje të tjera, që lidhen me punën e drejtorëve dhe drejtorive komunale, ndërsa, u vlerësuan edhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të shënimeve për 100 vjetorin e Pavarësisë së shtetit Shqiptar.

U zbulua busti i dëshmorit “Hamdi Berisha”

Malishevë, 26 nëntor



Në oborrin e gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë, u bë zbulimi i bustit të dëshmorit, emrin e të cilit e mban ky gjimnaz. Në ceremoninë e zbulimit përveç familjarëve të dëshmorit dhe kolektivit e nxënësve të gjimnazit, morën pjesë edhe i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj, zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj, deputetët e Kuvendi të Kosovës, z.Nait Hasani, z.Halit Krasniqi dhe znj.Hasime Krasniqi, z.Xhavit Jashari nga Shoqata e Familjeve të

Dëshmorëve dhe zyrtar e qytetar të shumtë.

Fillimisht për biografin e dëshmorit Hamdi Berisha, foli drejtori i gjimnazit, z.Agim Samadraxha, ndërsa të emër të Komunës së Malishevës, foli Kryetari z.Isni Kilaj. “Sot Hamdiun e kemi këtu në mesin tonë. Hamdiu foli njëherë e njëkohës, atëherë kur duhej të fliste trimi e trimëria, se liria nuk fitohej pa gjakun e tij e të dëshmorëve të tjerë, foli dh vendosi fjalë në pllakë guri, foli me ehon e luftës, foli me grykën e pushkës”, tha mes tjerash kryetari Kilaj.

Ndërsa, përfaqësuesi e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, z.Xhavit Jashari, pasi ka përgëzuar për ngritjen e bustit për dëshmorin “Hamdi Berisha”, nuk mundi ti ik as situatës së krijuar me rastin “Kleçka”. “Nuk mund të festojmë lirshëm, përderisa shokët tanë po arrestohen dhe po dhunohet drejtësia në Kosovë”, tha Jashari. Ai më pas bëri thirrje që mos të rrihet duarkryq para këtyre arrestimeve.

Bustin e dëshmorit Hamdi Berisha, e zbuluan, prindërit e dëshmorit, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Nait Hasani, gjeneral Selim Krasniqi dhe bashkëluftëtari dhe një prej donatorëve për ngritjen e bustit, z.Adil Thaçi.

Në fund të kësaj ceremonie, u bë e ditur, se Shkolla e Mesme Profesionale, do ta mbaj emrin “Abdyl Frashërit”, emër të cilin, deri vonë e kishte gjimnazi.

Reagimi i Kryetarit të Malishevës, z.Isni Kilaj, lidhur me rastin “Kleçka”



Komuna e Malishevës
Kryetari i Komunës
Malishevë datë 26. 11. 2011

Komuna e Malishevës pas paraburgosje së padrejtë të Çlirimtarëve Fatmir Limaj, Nexhmi Krasniqi, Naser Shala dhe Naser Krasniqi vazhdon të besoj thellësisht në pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe konsideron se përpjekjet për të njollosur këtë luftë nuk do të kenë sukses.

Jemi të bindur se “Rasti Kleçka” është një rast i improvizuar nga i cili pjesëtarët e UÇK-së të cilët janë të akuzuar do të dalin triumfues sikur edhe më parë dhe në të gjitha rastet tjera për të cilët është treguar se kanë qenë të montuara me qëllim të njollosjes së luftës sonë të drejtë.

Jemi të indinjuar sepse edhe me këtë rast, drejtësia e EULEX-it në vend që të merret me ndjekjen dhe gjykimin e kriminelëve dhe bandave serbe të cilat masakruan qytetarë të pafajshëm po ndjek dhe paraburgos pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët u vunë në mbrojtje të viktimave të pafajshme.

Ne jemi të bindur në pafajësinë e tyre e cila në maj të këtij viti u vërtetua edhe nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë e cila dha verdiktin e saj lirues prandaj kërkojmë lirim të bijve tanë të cilët luftuan për kauzën e drejtë të popullit tonë.

K r y e t a r i,
Isni Kilaj ecc. i dipl.